



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. 3589 Prot.

Tiranë, më 21/11/2023

Lënda: Kërkesë për marrjen e masës disiplinore.

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA

KRYETARE E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Baza Ligjore: Neni 63, pika 1 gërma d), dhe neni 65/1 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3, gërma dh) dhe ë), neni 8, pika 2 gërma b) dhe neni 33 i Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Përsëritja e situatave të vazhdueshme të bllokimit të seancave plenare nga deputetë të opozitës është e pa tolerueshme.

Kaosi i krijuar nga deputetë të caktuar të opozitës në seancën plenare të datës 20.11.2023, seancë dedikuar diskutimeve dhe votimit në parim të Buxhetit 2024 dhe Paketës Fiskale, pengoi zhvillimin normal të kësaj seance të rëndësishme duke mos lejuar të mbanin fjalën deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste të cilët ishin regjistruar për të diskutuar.

Ky skenar i përsëritur për të disatën herë nga deputetë të opozitës është në kundërshtim flagrant me Rregulloren e Kuvendit dhe Kodin e Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë.

Deputetë të opozitës që në nisje të seancës plenare bllokuan foltoren duke vendosur si barrikadë para saj karriget e deputetëve.

Deputeti Gazment Bardhi mori karriget e deputetëve dhe i vendosi mbi foltore duke e bllokuar atë. Deputeti Bardhi konfliktohet me punonjësit e sigurisë në sallën plenare dhe në një moment ai hedh një karrige në drejtim të tyre duke dëmtuar rëndë njërin prej gardistëve në dorë.

Deputeti Flamur Noka gjithashtu mori karriget të cilat ishin vendosur si barrikadë në një nga hyrjet e sallës plenare dhe i vendosi mbi foltore duke e bllokuar atë. Deputeti Noka mban dy flakadanë duke i drejtuar ato drejt Drejtueses së Seancës, Kryeministrit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave. Në mblyetje të seancës deputeti Flamur Noka hedh një flakadanë të ndezur drejt Kryeministrit.

Deputeti Bledjon Nallbati nga vendi ku ulet merr flakadanë nga çantat e deputetëve Sorina Koti dhe Albana Vokshi të vendosura mbi tavolinë dhe i ndez ato duke shkaktuar kaos në sallë.

Situata agravoj edhe më shumë në momentin kur deputeti Bledjon Nallbati nxjerr nga çanta e deputetes Albana Vokshi një kuti të cilën sapo e ndezi mori menjëherë flakë, gjithashtu i ndihmuar edhe nga deputeti Flamur Hoxha këtë kuti e vendosi në tavolinën përpara, duke dëmtuar pajisjen elektronike të votimit dhe rrezikuar që flakët të përhapeshin në sallë. Kjo situatë shkaktoi panik dhe tek vetë deputetët e opozitës.

Nisur nga këto situata të krijuara në seancën plenare të datës 20.11.2023, në mbështetje të nenit 63, pika 1 gërma d), dhe nenit 65/1 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 3, gërma dh) dhe ë), nenin 8, pika 2 gërma h) dhe nenin 33 të Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, paraqesim kërkesën si më poshtë:

- Marrjen e masës disiplinore ndaj deputetëve Gazment Bardhi, Flamur Noka, Bledjon Nallbati, Sorina Koti, Albana Vokshi dhe Flamur Hoxha sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

- Mbledhjen e Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën për vlerësimin e masës disiplinore.

DEPUTETËT :

1. Adend Ballo 
2. Ismet Beqiraj 
3. Xuan Dabizi 
4. DENIS DELIU 
5. Gerta Rexhepi 
6. Muela Fetushi 
7. Lindita Buxheti 
8. Antrim Akum 
9. Nily Beqiri Akum